

ANEKS 4

Për funksionet e transferuara në njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. Konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën e vitit 2024, disa bashkive u janë akorduar fondet për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë përfshihen fondet për shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), për shpenzimet operative dhe për shpenzimet për investime.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

2. Qëndrat e Shërbimeve Sociale

Në transfertën e vitit 2024 të bashkive, Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Fier, Kuçovë dhe Kukës janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore për personelin shërbyes dhe shpenzime operative për qendrat, “Lira”, Berat, “Balash”, Elbasan, “Shpresa” Shkodër, “Opera Della Madonnina Della Grappa”, Shkodër, “Besa” Vau i Dejës, “Horizont”, Fier dhe qendrat ditore të fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për bashkitë Kuçovë dhe Kukës.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre qendrave bashkitë Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Fier, Kuçovë, dhe Kukës do të mbështeten në kuadrin rregullator që përdor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këto qendra.

3. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH)

Në transfertën e vitit 2024 të bashkive, është akorduar fondi për funksionin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Ministria e Brendshme duhet t’u dërgojë bashkive kuadrin ligjor dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me shërbimin. Në tabelën nr.3, të ligjit vjetor të buxhetit, është pasqyruar edhe efekti i rritjes së pagave për këtë funksion për vitin 2024, në zbatim të vendimit nr.240 datë 20.04.2023 “Për një ndryshim në Vendimin nr.350 datë 19.04.2017, të Këshilli të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, të ndryshuar.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

4. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar

Në transfertën e vitit 2024, njësive të vetëqeverisjes vendore u janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar nuk përfshihet arsimi i mesëm profesional. Në tabelën nr.3, të ligjit vjetor të buxhetit, është pasqyruar edhe efekti i rritjes së pagave për këtë funksion për vitin 2024, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.241 datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.175, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

5. Rrugët rurale

Në transfertën e vitit 2024, njësive të vetëqeverisjes vendore u është akorduar fondi për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në rrugët rurale.

6. Administrimi i pyjeve

Në transfertën e vitit 2024, njësive të vetëqeverisjes vendore u është akorduar fondi për Shërbimin Pyjor. Në tabelën nr.3, të ligjit vjetor të buxhetit, është pasqyruar edhe efekti i rritjes së pagave për këtë funksion për vitin 2024, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242 datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.234 datë 20.04.2022, të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

7. Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën e vitit 2024, njësive të vetëqeverisjes vendore u është akorduar fondi për ujitjen dhe kullimin. Në tabelën nr.3, të ligjit vjetor të buxhetit, është pasqyruar edhe efekti i rritjes së pagave për këtë funksion për vitin 2024, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242 datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.234 datë 20.04.2022, të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

8. Klubet sportive shumësportëshe , “Partizani” dhe “Studenti”

Në transfertën e vitit 2024, bashkisë Tiranë i janë akorduar fondet për shpenzime për personelin dhe për shpenzime operative për klubet sportive shumësportëshe “Partizani” dhe “Studenti”. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Bashkia Tiranë mund të shtojë fonde nga të ardhurat e veta për të rritur cilësinë e shërbimit në këto klube.